

Npi – 01/118 datë: 28.03.2023

Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14.1, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Ligji Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Nenin 53 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/207 të datës 21.03.2024, në seancën e mbajtur më 28.03.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MARRJEN E TË DREJTËS SË SHFRYTËZIMIT TË NGASTRËS KADASTRALE Nr.2148-4 NGA NPKSH “HIGJIENA” - SHTIME

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 28.03.2024, me shumicën e votave miratoi Vendimin për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të paluajtshmërisë nga NPKSH “Higjiena” në Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-02148-4. Zona Kadastrale – Shtime. Me sipërfaqe prej 2000m². Kualiteti i klasës – Mal i klasës së dytë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Komunës – Shfrytëzues NPKSH – “Higjiena” Komuna Shtime.

II

A r s y e t i m: Komuna e Shtimes me vendimin Nr.01/347/2 të datës 27.09.2002 i ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm NPKSH “Higjiena” – Shtime, (tani – KRM-“Pastërtia”) sipërfaqen e tokës prej 2000m² (20 ari) në Ngastrën Kadastrale me numër P-72809093-02148-4, në Zonën Kadastrale – Shtime, për nevoja të veta të objektit të administratës dhe autoparkut. Duke marrë për bazë Marrëveshjen Nr.02/354 të datës 27.10.2022, ndërmjet Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB) dhe Komunës së Shtimes për Bashkëfinancim dhe Realizim të Projektit “Ndërtimi i Objektit të Komunës së Shtimes” në vlerën totale të projektit 2.5 milion euro, të cilat janë buxhetuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës, është paraqitur nevoja imediate për sigurimin e lokacionit për këtë destinim, meqenëse Komuna e Shtimes si subjekt publik nuk posedon paluajtshmëri e cila evidentohet në emër të Komunës e që i plotëson kushtet për ndërtimin e objektit të ri të administratës të Komunës së Shtimes, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit sipas dispozitivit të këtij vendimi.

III


Drejtorja për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe ligjore për implementimin e këtij vendimi.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit
Adnan Ademi